



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 16, datë 24.01.2022

**PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT TË KRITEREVE TË POSAÇME TË KANDIDATËVE PËR NGRITJEN NË DETYRË NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË VLORË**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 47 pika 6 dhe 52 të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa "a" të Ligjit nr.115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", i ndryshuar, në nenin 22, germa "c" dhe 25 të Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm", me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë shkallën e vlerësimit për secilin kriter të posaçëm dhe për secilin kandidat për Drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, si më poshtë:

Nr	Emri e mbiemri i kandidatit	KOMPONENTËT E VLERËSIMIT TË AFTËSIVE SIPAS SHKALLËVE			
		Aftësitë e organizimit në punë dhe drejtimi	Aftësitë në hartimin dhe miratimin e akteve administrative dhe ligjore	Aftësitë në ndërveprimin me median	Aftësi të tjera
1	Albert Kuliçi	Nivel i mesëm	Nivel i ulët	Nivel i ulët	Nivel i ulët
2	Aurel Zarka	Nivel i mesëm	Nivel i ulët	Nivel i ulët	Nivel i ulët

2. Relacioni i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**



**KRYETAR  
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA**



**ANËTAR  
SOKOL STOJANI**

**ANËTAR  
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR  
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR  
ELOIDA GOXHI**

**ANËTAR  
ESMERALDA KESHI**

**ANËTAR  
LUDOVIK DODAJ**

**ANËTAR  
ZEQIR HODA**

**ANËTAR  
SANDËR BECI**

**ANËTAR  
TARTAR BAZAJ**